

U D H Ë Z I M
Nr. 41, datë 29.5.2001

**PËR PËRCAKTIMIN E AFATEVE KOHORE PËR PRANIMIN E DOKUMENTACIONIT TË
KANDIDATËVE PËR DEPUTETËT NGA KKZ-JA**

Në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe të nenit 79 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 “Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, Komisioni Qendor i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Kur një kandidat për deputet dorëzon në Komisionin e Zonës Zgjedhore dokumentacionin për regjistrimin si kandidat për atë zonë, KKZ-ja duhet ta shqyrtojë kërkesën e paraqitur brenda 24 orëve nga data e paraqitjes së kësaj kërkesë, duke marrë vendimin përkatës. Kërkesa e paraqitur duhet të bëhet nga kandidati në përputhje me afatet kohore të parashikuara në nenin 76 pika 1 të Kodit Zgjedhor.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi